

Raporti i Auditimit për Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për Vitin përfundimtar më 31/Dhjetor/2019	Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vitit 2019	31 Gusht	Viti/2020
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------	----------	-----------

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vitit 2019

Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit

Çështjet	Rekomandimi	Veprimet e Menaxhmentit për Implementim të rekomandimeve.	Data e planifikuar për implementim	Adresimi
Çështja A1- Shpenzimet shtesë për pagesat me vendime gjyqësore	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.	Çështja e Pagesave gjyqësore do të trajtohet nga njesitë të cilët bëjnë shpenzimet dhe të njejtat të sigurohen se përfundohet brenda afateve për pagesë.	Gjatë vitit 2020 dhe në vijim	Mbajtësit e buxhetit

<p>Çështja A2 - Mos hapja e bizneseve Start-up</p>	<p>Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat të projektit Start-up, me qëllim të vlerësimit të objektivave të ministrisë. Kjo situatë kërkon një vlerësim rigoroz në këtë vit, të përcaktohen qartë përgjegjësitë në vendimmarrje, në mënyrë që të përmbillet procesi i krijimit të bizneseve nga përfituesit, apo në të kundërtën të kthimit të mjeteve.</p>	<p>Monitorimi do të bëhet nga Komisioni i Monitorimit për vitin 2019 dhe projektete do të përfundohen, në të kundërtën do të sigurohet të bëhet kthimi i mjeteve.</p>	<p>Gjatë vitit 2020 dhe në vijim</p>	<p>Komisioni për Monitorimin e Star-Up për vitin 2019</p>
<p>Çështja B1- Mos raportimi nga përfituesit e subvencioneve dhe transfereve</p>	<p>Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Startup-et, për sigurimin e dëshmimeve të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.</p>	<p>Duke u bazuar në; RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE-,Komisioni Monitorues në bazë të vendimit 05/2019, të datës 10.01.2019 ,ka monitoruar në terren 18 OJQ përfituese. Me ndryshimin e Vendimit 05/2019, në Vendimin 573/2019 , Komisioni Monitorues ka monitoruar 25 OJQ, nga gjithësej 55 Ojq-përfituese.Komisioni Monitorues i përbërë nga 3 anëtar dhe 1 rezerve, ka monitoruar vetëm në bazë të dokumentacionit që i kanë dërguar Ojq-të përfituese. Raporti përfshin raporte narrative dhe financiare.</p>	<p>Gjatë vitit 2020 dhe në vijim</p>	<p>Komisionet Monitorues për OJQ dhe Star-Up për vitin 2018</p>

		<p>Në bashkëpunim me zyren e Informimit, Komisioni është dakorduar dhe i kemi dërguar vërjetje tek Ojq-të, të cilat nuk kanë dërguar raporte financiare dhe narrative.</p> <p>Procesi i monitorimit është në vazhdimësi, mirëpo për shkak të situatës së krijuar me pandeminë dhe me fuzionim të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, procesi i monitorimit ishte ndërprerë përkohësisht, kurse tani komisioni ka rifilluar punën e tij.</p> <p>Komisioni Monitorues i START-UP bazuar në Udhëzimin Administrativ (MIN) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve ka bërë monitorimin e raporteve të gjithë përfituesve, të gjithë ata të</p>		
--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

		<p>cilët nuk kanë raportuar i është dërguar Vërejtje me shkrim dhe është paralajmruar për masat e me tutjeshme për shkak të mos raportimit dhe mos përmbushjes së Marrvëshjes mes MIN dhe përfituesit.</p> <p>Bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 21 Proceduara e Mbylljes së Projekteve të UA (MIN) nr.01/2018, Komisioni ka kontrolluar raportet e dorëzuara nga përfituesit dhe pas verifikimit raporti është dërguar në Divizionin për Buxhet dhe Financa.</p> <p>Bazuar në pikën 5 dhe 6 të nenit 21 Proceduara e Mbylljes së Projekteve të UA (MIN) nr.01/2018, në rast të shkeljeve të rënda të marrëveshjes Komisioni është në fazen përfundimtare të</p>		
--	--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

		përgatitjes së rekomandimeve për hapat e mëtejshëm, kjo për arsye të numrit të madh të përfituesve, përkushtimit si dhe ndjeshmërisë që kërkon secila dosje gjatë monitorimit të saj.		
Çështja A3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve	Ministri duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode dhe kategori ekonomike adekuate, siç parashihet me planin kontabël të SIMFK me qëllim të prezantimit dhe shpalosjes së informatave të drejta për shfrytëzuesin e raporteve financiare.	Nga divizioni i financave do të sigurohet se nuk do të kodohen shpenzimet në kode të gabuara, por do të përdoren kodet adekuate sipas planifikimit të buxhetit për projekte adekuate.	Gjatë vitit 2020-21	Divizioni i Financave dhe mbajtësit e buxhetit
Çështaj B2- Dobësitë në regjistrimin e pasurive	Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet kapitale të regjistruhen në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim të barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia. Po ashtu, të siguroj se stoqet janë regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç kërkohet me Rregullore.	Nga çdo Njësi Implementuese e projektit të sigurohet që pas përfundimit të çdo projekti kapital të sigurohet një Lëndë (kopje) e përfundimit të projektit, për të gjitha projektet që përfundojnë brenda vitit fiskal si dhe për të gjitha projektet që janë në vijimësi të sigurohet një raport preliminar për punët e kryera deri më	Gjatë vitit 2020 dhe në vijim	Zyrtari i pasurisë dhe Mbajtësit e buxhetit

		31/Dhjetor/. Po ashtu do të sigurohet se stoqet janë regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç kërkohet me Rregullore,		
Çështaj B3 - Mos inventarizimi i pasurisë së MIN	Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare të organizatave buxhetore. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në raportimet vjetore.	Ministria do të bëjë inventarizimin.	Gjatë vitit 2020 dhe në vijim	Zyrtari i pasurisë dhe Mbajtësit e buxhetit
Çështaj A4- Vonesa në realizimin e pagesave të detyrimeve	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç parashihet me neni 39 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.	Divizioni i Financave do të sigurojë se do të monitorohen faturat dhe të paguhen brenda afatit, nesë janë pranuar sipas rregullave financiare dhe duke respektuar kontratën.	Gjatë vitit 2020 dhe në vijim	Divizioni i Financave



 Data: 31/08/2020

